

1. SHËRBIMI

1.1 Shërbimi i transferimit të parave ("Shërbimi") kryhet nga EasyPay, me seli në Rruga Ibrahim Rrugova, Kompleksi Green Park, Kulla 1, 1019, Tiranë, Shqipëri ("EasyPay"), institucion financiar jobankë, me NIPT [....], me licence nr. [....], datë [....]. EasyPay është agjent i autorizuar ne Shqipëri e Continental Exchange Solutions, Inc. dba RIA Financial Services, shoqëri e së drejtës se Kansas U.S.A., me seli në 7001 Village Drive, Suite 200, Buena Park, California 90621 U.S.A. ("RIA"). Shërbimi kryhet në Shqipëri nga EasyPay dhe/ose nga agjentët e EasyPay ("Agjentët") dhe për jashtë Shqipërisë nga RIA dhe/ose korrespondentët e saj.

1.2 Me a) plotësimin dhe nënshkrimin e formularit për marrjen e shumës monetare ("Paratë") apo formularit të dërgimit të Parave ("Marrje e Parave" dhe/ose "Dërgimi i Parave" së bashku ose veç e veç si me poshtë "Transferta"); b) identifikimin e Klientit Përfutues apo Klientit Urdhërues sipas rastit nga EasyPay dhe/ose Agjentët, si dhe c) dorëzimin apo pagimin e Parave të Transfertes nga Klienti Urdhërues, Ju pranoni Shërbimin sipas këtyre kushteve kontraktore ("Kushtet e Përgjithshme"). Kushtet e Përgjithshme së bashku me formularin përkatës të Transfertes, përbejnë kontratën midis Jush dhe EasyPay. (Për më shumë informacion vizitoni faqen tonë të internetit në adresën: www.easypay.al dhe www.riafinancial.com).

2. KUSHTET

2.1 Transferta i paguhet Klientit Përfutues në Cash (Para Fizike) ose sipas rastit në llogarinë bankare të paracaktuar nga Klienti Urdhërues ("Llogaria Bankare").

2.2 Nëse Transferta është në Cash normalisht i paguhet Klientit Përfutues në zyrat e EasyPay apo Agjentit të paracaktuar nga Klienti Urdhërues. Transferta në Cash i paguhet Klientit Përfutues brenda orarit zyrtar të ditës së punës në të cilën EasyPay apo Agjenti ka në dispozicion Transferten. Orar zyrtar kuptohet orari i shpallur nga EasyPay dhe/ose Agjenti pranë zyrave dhe ditë pune është çdo ditë kalendarike përveç ditës së shtunë apo të djele apo ditë feste zyrtare. Transferta në Cash behet me prezantimin nga ana e Klientit Përfutues të detajeve të Transfertes dhe veçanërisht: numrin PIN, emrin e Klientit Urdhërues dhe emrin e Agjentit të Klientit Urdhërues. Nëse Transferta paguhet në Llogari Bankare, EasyPay nuk mban përgjegjësi për a) kreditimin e Llogarisë Bankare nga banka e përcaktuar; b) komisionet shtese bankare të bankës së përcaktuar; c) kursin e këmbimit valutor të aplikuar nga banka e përcaktuar si dhe detyrimet tjera jashtë kontrollit dhe/ose përgjegjësisë të EasyPay dhe/ose Agjenteve. EasyPay apo Agjenti ka të drejtë të kontaktojë Klientin Përfutues për verifikimin e informacionit të Llogarisë Bankare.

2.3 Me plotësimin dhe nënshkrimin e formularit të Transfertes, Ju informoheni mbi afatin maksimal të kryerjes së Transfertes, komisionet për Shërbimin dhe kursin e këmbimit valutor, nëse aplikohet. Afati i Transfertes mund të zgjatet për shkak të rrethanave apo kushteve specifike të vendit të Klientit Përfutues dhe për këtë EasyPay nuk është përgjegjës për afatin e kryerjes së pagesës së Transfertes. Me plotësimin dhe nënshkrimin e formularit të Transfertes nëse Transferta paguhet në Llogari Bankare të Klientit Përfutues, është nën përgjegjësinë tuaj të përcaktoni saktë të dhënat e llogarisë bankare të Klientit Përfutues, në të kundërt, EasyPay rezervon të drejtën për të zbritur nga Transferta tarifën e zbatuar nga banka pritëse, nëse aplikohen. EasyPay nuk është përgjegjës ndaj Klientit Urdhërues apo Klientit Përfutues si mbajtësi i llogarisë bankare për ndonjë tarifë, komision, kurs këmbimi valutor apo veprim tjetër të çdo ndërmjetësi tjetër financiar jashtë EasyPay ose Agjentëve të saj dhe RIA ose Korrespondentëve të saj. Ju detyroheni të njoftoni Klientin Përfutues për Transferten dhe konkretisht për: numrin PIN, emrin e Klientit Përfutues, emrin e Agjentit të Klientit Urdhërues dhe emrin e Agjentit të Klientit Përfutues.

2.4 Ju detyroheni të paraqisni dokument identifikimi të vlefshëm ("ID") me kërkesën më të parë nga EasyPay apo Agjenti i saj për kryerjen e Shërbimit. EasyPay dhe Agjentët e saj nuk janë të detyruar të pranojnë kërkesat tuaja për Shërbim dhe rezervojnë të drejtën të refuzojnë formularin tuaj për Transferte kur ka dyshime të arsyeshme për autenticitetin dhe vlefshmërinë e IDse. Ju duhet të siguroni të dhënat e sakta, të plota dhe ligjore që kërkohen për të realizuar Shërbimin, përndryshe EasyPay apo Agjentët e saj nuk mund të realizojë Transferten.

2.5 Të gjitha të dhënat përkatëse të Transfertes do të jepen në momentin e plotësimit të formularit dhe Klienti Urdhërues duhet t'i japi ekskluzivisht Klientit Përfutues të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me Transferten.

3. KOMISIONET

Komisionet për kryerjen e Shërbimit janë vetëm në ngarkim të Klientit Urdhërues dhe do të jenë të afishuara dukshëm në zyrat/ambientet e EasyPay dhe/ose Agjentëve të saj ose do t'i tregohen Klientit Urdhërues përpara plotësimit të formularit. Klienti Urdhërues duhet të paguajë të gjithë komisionin për Shërbimin në momentin e nënshkrimit të formularit.

4. TËRHEQJA DHE KTHIMI I PARAVE

Klienti Urdhërues ka të drejtë të anulojë Transferten në çdo kohë, me kusht që të mos jetë ekzekutuar, që do të thotë, Paratë të mos jenë tërhequr nga Përfutuesi. Për të kryer anulimin e Transfertes, Klienti Urdhërues duhet të paraqitet tek i njëjti Agjent, ku është kryer dërgimi, duke treguar formularin e Transfertes në origjinal, së bashku me IDnë. Në rast se pagesa e parave e Transfertes nuk i është bërë ose llogaria bankare nuk është kredituar, Klientit Përfutues brenda një periudhe prej 15 ditëve nga data në të cilën është kërkuar Transferta, EasyPay në bazë të një kërkesë me shkrim të Klientit Urdhërues do të kthejë Paratë e Transfertes.

5. MONEDHA DHE KEMBIMI VALUTOR

Transferta kryhet në monedhën e kërkuar prej Jush. Nëse monedha të cilën Klienti Urdhërues paraqet tek një Agjent nuk është monedha që do të tërhiqet nga Klienti Përfutues atëherë e gjithë shuma këmbëhet sipas kursit të këmbimit në momentin kur kryhet Transferta, në bazë të këmbimit valutor të azhronuar çdo ditë. Kursi i këmbimit i zbatuar nga EasyPay mund të jetë i ndryshëm nga kursi i këmbimit të zbatuar nga RIA Financial Services ose nga ndërmjetësit financiarë pritës. Në rast se Përfutuesi kërkon të tërheqë shumën e transferuar në një monedhë të ndryshme nga ajo e përcaktuar nga Klienti Urdhërues, EasyPay nuk mban përgjegjësi për kursin e këmbimit valutor që mund të zbatohet në vendin pritës.

6. KUFIZIMI I SHËRBIMIT

Shuma monetare objekt Transferte nuk mund të jetë më e madhe se shuma monetare e përcaktuar dhe e publikuar herë pas here nga EasyPay apo Agjentët e saj. Gjithsesi, shuma monetare maksimale për veprimet "Cash to Cash" ose "Cash to Account" nuk mund të tejkalojë kufizimet sipas legjislacionit në fuqi. Të gjitha transaksionet e kryera me anë të EasyPay regjistrohen. EasyPay dhe Agjentët e saj e kanë në detyrë të kryejnë kontrollin e kërkuar nga legjislacioni për parandalimin e pastrimit të parave, kundër korupsionit dhe ai në luftën kundër terrorizmit: kjo mund të sjellë një kërkesë për informacion shtesë për ju dhe Klientin Përfutues, vonesa në kryerjen e Transfertes deri në refuzimin e Shërbimit. Në rast se Transferta nuk realizohet, jeni të lutur të kontaktoni EasyPay për tu informuar në përputhje me politikat dhe legjislacionin në fuqi.

7. PERGJEGJESIA

7.1 EasyPay nuk merr asnjë përgjegjësi për vonesat ose pamundësitë për të kryer Transferten sipas porosisë të Klientit Urdhërues dhe që shkaktohen nga ligjet apo rregulloret në fuqi në vendin e Klientit Përfutues ose nga rrethanat tjera që shkojnë përtej kontrollit të EasyPay, ose që gjithsesi nuk mund t'i atribuohen EasyPay. Për çdo rast, EasyPay përgjigjet deri në vlerën e Transfertes të përcaktuar në formular të Transfertes, përfshirë komisionet për Shërbimin.

7.2 EasyPay nuk mban përgjegjësi për ndonjë dëm si rrjedhojë e vonesës apo mos realizimit të Transfertes, mesazheve apo rikthimit të Parave, përveç rasteve kur provohet se demi është shkaktuar si rezultat i veprimeve të kundraligjshme dhe me faj të rëndë të EasyPay. EasyPay dhe/ose Agjentët e saj nuk janë përgjegjës nëse Klienti Urdhërues i komunikoi ndonjë personi tjetër përveç Klientit Përfutues.

8. PERPUNIMI I TE DHËNAVE PERSONALE

Vënia në dispozicion e të dhënave personale nuk është e detyrueshme por është e nevojshme për kryerjen e shërbimit të transferimit të parave nga Klienti Urdhërues tek Klienti Përfutues; refuzimi i të dhënave personale e bën të pamundur kryerjen e shërbimit. Përpunimi i të dhënave personale shërben edhe për përmëshjen e detyrimeve sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Shqipëri dhe/ose në vendin pritës, ndajautoriteteve të ngarkuara nga ligji për qëllime që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave. Të dhënat personale mund t'i zbulohen palëve të treta në Shqipëri dhe jashtë vendit, madje edhe në vendet që nuk ofrojnë të njëjtat garanci për mbrojtjen e të dhënave personale, subjekteve dhe/ose organeve publike dhe private, autoriteteve publike, shoqërive në grupin e të cilave bën pjesë EasyPay, nëse është e nevojshme për të kryer ose ndihmuar transferimin e parave, shërbimet e ardhshme, ose për arsyet e tjera të përcaktuara në këtë paragraf. Komunikimi palëve të treta i të dhënave personale mund të kryhet edhe për të ndihmuar parandalimin dhe zbulimin e krimit. Ju keni të drejtë të kërkonit që informacioni mbi të dhënat tuaja të korrigjohet ose të tërhiqni pëlqimin tuaj për përdorimin në marketing në çdo kohë duke na dërguar një njoftim pranë shërbimit të klientit.

9. SHËRBIMI I KLIENTIT

Ju mund të kontaktoni Shërbimin e Klientit të EasyPay duke na telefonuar në numrin: +355 42 264982 ose me e-mail në adresën: info@easypay.al, nga e Hëna në të Shtunë, në orarin 9:00 am deri në 9:00 pm, sipas orës lokale në Shqipëri, ose RIA Financial Services në numrin +34 917 613 760 ose me e-mail në adresën: europs@riafinancial.com

10. LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Kjo kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjin shqiptar. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kontratës, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim atëherë do t'i paraqiten për zgjidhje Gjykatës kompetente në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

I nënshkruari në këtë formular, duke konfirmuar në tërësi të gjitha të dhënat e formularit dhe përcaktimet e Kontratës më sipër, deklaron se miraton shprehimisht parashikimet e Kontratës në nenet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10 sipas dispozitave të nenit 686 të Kodit Civil.